

## **EVIS KUSHI**



**Datëlindja:**07.10.1975

**Vendlindja:**Elbasan

**Email:** Evis.Kushi@parlament.al

### **Jetëshkrimi:**

Evis Kushi është diplomuar në vitin 1997 në degën Administrim - Biznes (Marketing), Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Në vitin 2008 fitoi gradën shkencore “Doktor” (PhD) në Ekonomiks-Turizëm, Universiteti “Staffordshire”, Angli.

Në nëntor të 2010 fitoi titullin akademik “Profesor i Asociuar,” në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Gjashtë vjet më vonë, më 26 korrik 2016, Kushi mori edhe titullin akademik “Profesor” në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Evis Kushi e nisi karrierën e saj në vitin 1998 si lektore në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, në lëndët kryesore “Bazat e Marketingut” dhe “Ekonometri” (1998-2012).

Mes viteve 2010-2012, Kushi mbajti pozicionin e shefes së Departamentit “Ekonomia dhe e Drejta”, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Në 2012-2013 shërbeu si dekan e Fakultetit të Ekonomisë, në po këtë universitet.

Nga viti 2013 e në vazhdim, Kushi është deputete e Qarkut të Elbasanit në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe ka qenë pjesë e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Njëkohësisht, ka shërbyer edhe si pedagoge me kohë të pjesshme në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan dhe në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë.

Për sa u përket aktiviteteve shoqërore politike, Evis Kushi është anëtare e Partisë Socialiste që prej Marsit 2013 dhe anëtare e Kryesisë së Partisë Socialiste që prej Prillit 2016.

Deri në momentin e marrjes së pozicionit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë(2020) ajo ka qenë Nënkryetare e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Ka marrë pjesë në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe është autore e bashkë autore e një sërë artikujsh shkencorë në revista brenda e jashtë vendit.

